



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “N.T.P. Thesar – Visar Kuçi B.I.” të datës 14.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës – Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “N.T.P. Thesar – Visar Kuçi B.I.” Sh.P.K. e datës 14.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës – Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “N.T.P. Thesar – Visar Kuçi B.I.” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “N.T.P. Thesar – Visar Kuçi B.I.” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 14.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i fushave sportive në Komunën e Prishtinës – Fusha në Hajvali” me nr. të prokurimit 616-23-7934-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): *“Në kërkesat e përshtatshmërisë AK ka kërkuar dëshmitë si në vijim: Një vërtetim nga administrata tatimore ... Një vërtetim nga Gjykata ... GOE i rekomanduar nuk i ka këto dëshmi sikurse janë kërkuar me FDT”.*

Pretendimi i dytë (II): *“Në kërkesat e Kapaciteti ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar: dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 450.000,00 euro (60% Bartësi i konzorciumit)... Deklaratat e dorëzuara në ATK apo konfirmimin nga banka... GOE i rekomanduar nuki ka këto dëshmi siç është kërkuar në FDT”.*

Pretendimi i tretë (III): *“Në kërkesat e kapaciteti teknik dhe profesional, AK ka kërkuar: dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit në vlerë minimale prej 450.000,00 euro (60% bartësi i konzorciumit)... Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 6 të DT... GOE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e FDT për kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional”.*

Pretendimi i katërt (IV): *“ Në Letrën standarde që na ka dërguar AK, na ka informuar se ne jemi eliminuar për arsye si në vijim - Ju mungon dëshmia për inxhinierin e ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv dhe që ne kemi çmimin më të lartë se GOE i rekomanduar. Arsyeja e dytë që ne kemi çmimin më të lartë do të ishte arsyeje vetëm sikur AK do të na vlerësonte që ne kemi përmbushur kërkesat e FDT... Ndërsa arsyeja që ne nuk kemi inxhinierin e ndërtimtarisë nuk qëndron fare sepse ne si GOE kemi dy inxhiniera të ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv...”*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 65, 66, 68 dhe 69 të LPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka trajtuar të gjitha pretendimet e paraqitura në kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se janë dorëzuar dokumentet të cilave ju referohet pretendimi ankimor. Prandaj ky pretendim është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) dhe të tretë (III) ankimor, nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara dokumentare në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe financiare si dhe në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional. Prandaj këto dy pretendime janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) ankimor, duhet sqaruar se mënyra e formulimit të pretendimit ankimor është mjaft kundërtshënese pasi që vet parashtruesi e konfirmon faktin se çmimi me të cilin ka ofertuar është më i lartë se çmimi me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Në anën tjetër në kudër të kërkesës për rishqyrtim nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi dokumentare për të mbështetur pretendimin e tij ankimor. Së këndejmi edhe ky pretendim është i pabazuar në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.10.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.